



www.sevenwomen.se

Qendra per Nisma Ligjore Qytetare
web: www.qag-al.org
Tel: +355 4 2259795
Mob: +355672754655




CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Prag

Pjesë sociale e dramatizuar,
kushtuar sfidës së grave të
dhunuara shqiptare, në kërkim
të identitetit të tyre, me ndihmën
e Qendrës për Nisma Ligjore
Qytetare.

Tiranë, 2014





Shfaqja socio-teatrale "PRAG" realizohet në 12 njësi vendore nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen e Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë dhe të Civil Rights Defenders, partnerë në projekt. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë performancë janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit dhe të Civil Rights Defenders.

PRAG është një shfaqje social-teatrale, që bazohet në rrëfimet e tre personazheve femërore në kohë dhe në rrethana të ndryshme. Për të dhënë një vështrim më të plotë, kemi përfshirë dhe tre personazhe meshkuj. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare përfaqësohet me anë të një personazhi, Avokates, e cila është boshti që i jep jetë dramës dhe gjeneron problematikën sociale. Për hir të anonimatit, por edhe të respektit për familjen, personazhet janë të sajua. Çdo ngjashmëri me emra dhe personazhe, është krejt e rastit.

Shfaqja është titulluar "Prag" për të treguar simbolikën e kalimit të disa personazheve gra shqiptare, nga një jetë e dhunuar dhe pa shpresë, në një gjendje tjetër, ku ato janë jo vetëm thjesht denoncuese, por edhe dorëzonia të fatit të tyre. Kalimi i *pragut* është momenti më i vështirë për të dhunuarit në shoqëritë njerëzore. Personazhet tona e bëjnë këtë përmes një katarsisi personal, që vjen me ndihmën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, e cila në këtë rast, më shumë se një organizëm të Shoqërisë Civile, përfaqëson zërin pozitiv të shoqërisë shqiptare. Sa u përket figurave të tjera e kryesisht, personazhet mashkullorë, janë zgjedhur në bazë të një reciprociteti. Kjo do të thotë, se në këtë shfaqje ata kanë edhe pjesën më të vështirë teknike, pasi duhet të interpretojnë në dy regjistra. Në regjistrin e parë, publiku duhet t'i identifikojë me maskë, ku ata me anë të deklamimit të tyre, përshfaqin gjendjen reale të një pjese jo të vogël të

grave të dhunuara në shoqërinë shqiptare. Kurse, në momentin kur ata heqin maskën brenda monologut, përballen me bashkëshortet e tyre të dhunuara. Stafi i "PRAG" në këtë rast, është kujdesur që të respektojë barazinë gjinore, prandaj gjuha e personazheve artikulon problematikën e vetë shoqërisë sonë.

Personazhi i vetëm, që do të ketë dhe peshën më të vështirë në këtë vepër, përfaqëson Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe roli i saj ka karakter deklarativ, didaktik, por edhe akuzues. Gishti s'është vetëm tek shoqëria, por edhe tek ne vetë.

Shpresojmë që "PRAG", të hapë një derë modeste për të rinjtë dhe të gjithë shoqërinë shqiptare.

Personazhet pjesëmarrës:

Hëna - Arsim i mesëm, e papunë. Është rreth 50 vjeç.

I shoqi – Arsim tetëvjeçar, i papunë, rreth 55 vjeç. Të dy banues në Tiranë. Kanë një fëmijë.

Ira - E punësuar, arsim i lartë. E lindur dhe banuese në Tiranë. Është rreth 38 vjeç.

I shoqi – Arsim i lartë. I lindur në një qytet në veri të vendit. Është rreth 42 vjeç. Kanë një fëmijë.

Blerina - Arsim i lartë. Është e punësuar. Është rreth 32 vjeç.

I shoqi - Arsim i lartë. Është i punësuar. Është rreth 35 vjeç.

Të dy banues në Durrës. Blerina ka dy fëmijë nga një martesë më parë dhe një me partnerin aktual.

Avokatja e Qendrës – Përfaqëson Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare. E pamoshë. Do jetë e mbuluar me tunikë.

Një fëmijë - Do bëjë fëmijët e dy çifteve, respektivisht e familjes së Hënës dhe të Irës.

Përgatiti: Ben Andoni

Udhëheqëse artistike: Aneta Malaj

